



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr 658 Akti

V E N D I M
(I NDËRMJETËM)

Nr. 4, datë 17.10.2023

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 12.10.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Flora Çela do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Brunilda Bekteshi dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bekteshi.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues komisioneri Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të

rivlerësimin për subjektin e rivlerësimin, znj. Flora Çela. Subjekti i rivlerësimin, me *email*-in e datës 2.2.2021, deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimin, znj. Flora Çela, nisi procesi i rivlerësimin dhe hetimi i thelluar administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimin. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret, në datën 28.9.2023, me vendimin e ndërmjetëm nr. 2, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimin Flora Çela, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimin për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

8. Në datën 28.9.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimin mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim subjektit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 9.10.2023.

9. Në datën 8.10.2023, subjekti i rivlerësimin, përmes postës elektronike¹, i dërgoi Komisionit parashtrimet dhe provat lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe i depozitoi ato pranë zyrave të Komisionit, protokolluar me nr. *** prot., datë 9.10.2023.

10. Në datën 6.10.2023, pranë Komisionit është depozituar për subjektin e rivlerësimin denoncimi nr. *** prot., datë 6.10.2023, i shtetasit K.B. Në datën 9.10.2023, Komisioni e njohu subjektin e rivlerësimin me denoncimin e këtij shtetasi, si dhe i kërkoi shpjegime lidhur me pretendimet e tij brenda datës 10.10.2023. Subjekti i rivlerësimin, po në datën 10.10.2023, paraqiti shpjegimet e saj dhe depozitoi dokumentacion sipas kërkimit të Komisionit, të cilat u administruan në dosjen e subjektit.

11. Komisioni, me vendimin nr. 3, datë 9.10.2023, vendosi ta ftojë subjektin për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës

¹ Me *email*-in datë 8.10.2023.

dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative. Në datën 10.10.2023, Komisioni nëpërmjet postës elektronike njoftoi subjektin se seanca dëgjimore do të mbahet në datën 12.10.2023, ora 10:00.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.10.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

13. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 12.10.2022 u ndërpre, për të rifilluar në datën 16.10.2023, ora 9:45, për shpalljen e vendimit. Në datën 13.10.2023, Komisioni për arsye objektive vendosi të shtyjë njoftimin e seancës për shpalljen e vendimit për në datën 17.10.2023, ora 9:45, duke njoftuar subjektin e rivlerësimit, si dhe duke e publikuar këtë shtyrje edhe në faqen zyrtare të tij.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Ajo është përgjegjës në kohë sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI

15. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); (e) raportin e analizimit të aftësive

profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; (g) shpjegimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore.

17. Komisioni vlerësoi që në këtë vendim të ndërmjetëm sipas nenit 60 të ligjit nr. 84/2016 “Pezullimi nga detyra dhe detyrimet për të ndjekur programin e trajnimit” të trajtojë vetëm ato çështje të cilat lidhen me kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke evidentuar mangësitë në aftësitë profesionale që mund të plotësohen me anë të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, bazuar në nenin E dhe në pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

18. Në lidhje me dy kriteret e tjera, Komisioni do të shprehet në vendimin përfundimtar pasi subjekti të ketë përfunduar programin e edukimit njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe të jetë testuar për aftësitë e saj.

V. VLERËSIMI PROFESIONAL

19. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar se subjektet e rivlerësimit vlerësohen sipas rastit për: (i) cilësi të pranueshme apo të papranueshme në punë; (ii) gjykim të drejtë apo të dobët; (iii) respektim apo mosrespektim të të drejtave të palëve ose viktimave; (iv) të qenit eficient dhe efektiv në masë të pranueshme apo të qenit joefektiv për të mbërritur përfundimisht në kualifikimin “i aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm” sipas përcaktimit të nenit 44, shkronjat “a”, “b” dhe “c”.

20. Sipas përcaktimit të nenit E, pika 2, fjalia e tretë e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, në objektin e vlerësimit të aftësisë për prokurorët përfshihen kriteret e aftësitë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj (ligji nr. 84/2016 dhe me referim për procedurat e vlerësimit nga ky i fundit edhe në ligjin nr. 96/2016). Qëllimi i vlerësimit të aftësive profesionale sanksionohet drejtpërdrejt nga neni E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësive profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.

21. Subjekti i rivlerësimit kualifikohet “Me mangësi” kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, me pasojë detyrimin nga Komisioni për të kryer program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës, me qëllim për të plotësuar këto mangësi brenda një viti sipas përcaktimit të nenit E, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

22. Trupi gjykues vlerëson se kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit, përkatësisht në të aftë, me mangësi apo të papërshtatshëm, kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilët rezultojnë të jenë të ndërthurur në tregues të natyrës cilësore dhe të vlerësueshëm dhe tregues të natyrës sasiore dhe të matshëm.

23. Sipas përcaktimit të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësive profesionale të prokurorit vlerësohet bazuar në aspektet e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, por pa gjykuar

korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

23.1 Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

23.2 Më tej, aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si: qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të Prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të Prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

24. Sipas përcaktimit të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësisë organizative, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit, vlerësohet në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe për të administruar dosjet gjyqësore.

24.1 Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i kushtohet çdo çështjeje, rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të Prokurorisë për një çështje.

24.2 Aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore dhe proceduar të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurat brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

24.3 Aftësia për të administruar dosjet e Prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.

25. Sipas përcaktimit të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet nëpërmjet etikës në punë, integritetit dhe paanësinë.

25.1 Etika në punë e magjistratit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit të tillë si: rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.

25.2 Integriteti i magjistratit në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm matet duke u bazuar në tregues të tillë si: rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit dhe/ose raportet e ILDKPKI-së.

25.3 Paanësia e magjistratit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si: përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi.

26. Sipas përcaktimit të nenit 76 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësisë personale dhe angazhimit profesional vlerësohen nëpërmjet aftësive të komunikimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmërisë për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

26.1 Aftësia e komunikimit të magjistratit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale. Vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar me të paktën “shumë mirë” ka përparësi në vlerësimin si magjistrat, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar.

26.2 Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe në shkëmbimin e njohurive apo të përvojës profesionale me ta.

26.3 Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera matet duke u bazuar në tregues të tillë si: pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike.

26.4 Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet duke u bazuar në informacionin e dërguar prej saj, në vlerësimin “shumë mirë”, në rastet e përmbushjes së detyrimit ligjor për të marrë pjesë në formim vazhdues jo më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë 5 viteve. Shkallët e tjera të vlerësimit përcaktohen me rend zbritës nga ky standard.

27. Komisioni, pasi analizoi: (i) raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë; (ii) të dhënat e administruara nga Prokuroria e Përgjithshme; (iii) denoncimet nga publiku dhe informacionet e aksesuara në media; (iv) dosjet penale të administruara për trajtimin e denoncimeve dhe ankesave; (v) shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe dëgjoi atë në seancë dëgjimore – arrin në përfundimin se:

27.1 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, me anë të së cilës Komisioni kishte evidentuar mangësitë profesionale në dosjet e verifikuara që lidheshin me: (a) kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykim; (b) vendime pushimi; (c) vendime mosfillimi të subjektit si prokuror i çështjes lidhur me vlerësimin profesional, sipas pikës 3 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

28. Për çështjen objekt shqyrtimi për subjektin e rivlerësimit Flora Çela, në funksion të provueshmërisë së fakteve që çojnë në vlerësimin e aftësive profesionale, janë administruar e analizuar nga Komisioni dokumentet ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nga të cilat kanë rezultuar mangësi profesionale që mund të plotësohen me anë të programit të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë vijon:

28.1 Për kallëzimin penal nr. *** të shtetasit F.M, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2015, të Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se subjekti në këtë çështje ka hetuar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, duke disponuar me vendim pushimi datë 22.10.2010. Rezultoi se vendimi i subjektit është shfuqizuar nga Prokuroria e Përgjithshme në bazë të ankesës së kallëzuesit.

28.1.1 Nga aktet në dosje u konstatuan: (a) zvarritje të çështjes, pasi rezultoi se kallëzimi është depozituar në datën 10.3.2009 dhe regjistrimi i procedimit është bërë në datën 7.12.2009, në kundërshtim me udhëzimin nr. ***, datë 27.10.2006, të Prokurorit të Përgjithshëm; (b) nuk ishin pyetur e sqaruar rrethanat e plota të çështjes së pretenduar nga kallëzuesi apo fakteve të dala gjatë hetimit, pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare; (c) subjekti në kërkimet hetimore për sqarimin e fakteve nuk bashkëlidh dokumentin që kërkohet të sqarohet/konfirmohet.

28.2 Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 18.9.2017, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier mbi bazë të kallëzimit të shtetasve I.B dhe M.B, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në datën 13.9.2017 ka vendosur “Mosfillimin e materialit kallëzues nr. ****” për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, vënë në lëvizje nga shtetasit B ndaj shtetasit K.U. Shtetasit B kanë pretenduar se shtetasi U ka ndërtuar pa leje në tokën e tyre në Dhërmi. Konstatohet se Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 29.3.2018, ka prishur vendimin e mosfillimit të çështjes, duke e quajtur atë të gabuar dhe ka urdhëruar organin e akuzës të kryhen veprime të tjera të nevojshme hetimore. Pas këtij vendimi subjekti ka regjistruar pa autor procedimin penal nr. ***, datë 2.7.2018, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

28.2.1 Nga aktet në dosje konstatohet se subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka kryer hetime shteruese, si dhe nuk ka konsideruar “sigurimin e padisë” apo çdo të dhënë tjetër të dalë gjatë hetimit dhe, për pasojë, nuk është vlerësuar drejt fakti penal²; (b) vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit si detyrë e lënë nga gjykata është marrë në kohë relativisht të gjatë nga vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, datë 13.10.2020; (c) nuk pasqyrohen në dosje veprime hetimore të kryera deri në caktimin e kryerjes së aktit të ekspertimit.

28.3 Lidhur me kallëzimin penal nr. *, *datë 27.07.2021, të shtetasës M.Ç, kundër shtetaseve E.L dhe M.Z, akuzuar për veprat penale të parashikuar nga nenet 147-149 të Kodit Penal, për të cilën subjekti ka disponuar me vendim mosfillimi datë 4.10.2021, në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm konstatohet se vendimi i mosfillimit (edhe në konsideratë të shpjegimeve të subjektit për ekzistencën e muajit gusht si kohë e kryerjes së pushimeve vjetore) është marrë në tejkalim të afatit 15-ditor, sikurse parashikohet në nenin 291/1 të Kodit të Procedurës Penale.

28.4 Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 16.7.2017³, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë në ngarkim të shtetasës A.S, për veprat penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt”, të parashikuara nga nenet 290 dhe 291 të Kodit Penal, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka dërguar për gjykim në datën 19.11.2018 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesën me objekt gjykimin e kësaj shtetaseje, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe pushimin e çështjes penale për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Kjo e fundit është rikthyer nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 27.6.2019, për hetime të tjera.

28.4.1 Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare, Komisioni konstatoi se subjekti: (a) nuk ka kryer

² Shtetasi U rezultoi përfundimisht i dënues për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, me vendimin nr. ***, datë 16.5.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

³ Ndjekur fillimisht nga një subjekt tjetër rivlerësimi. Sipas shortit datë 15.1.2018, hetimi ka vijuar të ndiqet nga subjekti i rivlerësimit Flora Çela.

veprimet e nevojshme hetimore për të përcaktuar qartë të gjithë mekanizmin e ngjarjes dhe sqarimin e rrethanave mbi dëmtimet e konstatuara tek viktimat nga ekspertët mjekoligjorë; (b) ka munguar në respektimin e afateve të caktuara nga gjykata, pasi Komisioni konstatoi se hetimet duhet të kryheshin brenda 2 muajve, ndërsa kërkesa për pushimin e çështjes nga subjekti është dërguar në Gjykatë në datën 7.7.2020, pas 6 muajve. Edhe në konsideratë të shpjegimeve të subjektit Komisioni konstatoi se përsëri afati i kryerjes së hetimeve pas kthimit nga Gjykata e Apelit është tejkaluar me 4 muaj; (c) nuk ka ndërmarrë veprime hetimore nga momenti i disponimit të akteve të procedimit penal nr. ***, rezultuar me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë për kthimin e çështjes, shkurt 2020 – 10.3.2020, kur edhe ka marrë vendimin për kryerjen e riekspertimit autoteknik (detyrë e lënë nga gjykata), si dhe pas rreth 4 muajve po nga disponimi i dosjes, në datën 19.5.2020 ka marrë vendimin për eksperimentin hetimor.

28.5 Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 27.9.2021, regjistruar si bashkim i procedimit penal nr. ***, datë 26.5.2021 dhe procedimit penal nr. ***, datë 27.9.2021, ndaj shtetasit M.M, akuzuar për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mosfilluar dy kallëzime të shtetasës O.O, e cila ka pretenduar për zaptim të dy apartamenteve në pronësi të saj, nga shtetasi M (vëllai i znj. O).

28.5.1 Nga aktet në dosje Komisioni konstatoi se kjo shtetase kishte depozituar materialin kallëzues nr. ***, datë 25.11.2020, i cili ishte mosfilluar nga subjekti i rivlerësimit në datën 1.12.2020 dhe mbi ankimin e saj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, kjo e fundit kishte shfuqizuar vendimin e mosfillimit të subjektit me vendimin nr. ***, datë 10.5.2021. Po ashtu, kjo shtetase kishte depozituar përsëri në organin e akuzës kallëzimin penal nr. ***, datë 8.1.2021, i cili gjithashtu ishte mosfilluar nga subjekti i rivlerësimit në datën 1.2.2021. Mbi ankimin e shtetasës O.O, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë kishte shfuqizuar përsëri vendimin e subjektit të rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 20.4.2021. Në të dyja vendimet urdhërohej regjistrimi i personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe vazhdimi i hetimeve duke përcaktuar, ndër të tjera, edhe kryerjen e aktit të ekspertimit, etj. Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm u konstatua se subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përsëritur ka reaguar me të njëjtin qëndrim/vendim mosfillimi mbi të njëjtin material kallëzues, mbi të njëjtat fakte e objekt kallëzimi. Subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në datën 27.9.2021, pas 4 muajve nga vendimi i gjykatës nr. ***, datë 10.5.2021, ku urdhërohej regjistrimi dhe vazhdimi i hetimeve. Subjekti i rivlerësimit, pas regjistrimit të procedimit penal të bashkuar në një të vetëm, ka munguar të kryejë veprimet hetimore në kohë, si. p.sh. ka disponuar me vendim për kryerje të aktit të ekspertimit për verifikim në terren të apartamenteve, në datën 29.12.2021, pas 3 tri muajve nga regjistrimi i procedimit penal datë 27.9.2021.

28.6 Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 18.12.2019, mbi bazën e materialit të referuar nga Komisariati i Policisë Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 4.12.2019, për veprën penale “Kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, rezultoi se mbi këtë material është marrë vendim pushimi datë 26.2.2020, i cili është ankimuar nga shtetasja R.B. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 13.10.2020, ka lënë në fuqi këtë vendim, i cili më tej është prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 22.12.2020, duke u kthyer çështja për hetime të tjera në drejtim të veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

28.6.1 Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm,

pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare, konstatohet se subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të identifikimit të elementeve të veprës tjetër penale.

28.6.2 Komisioni vlerëson se subjekti shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, si dhe në aspektin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 dhe në pikën 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

28.7 Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 7.7.2018, regjistruar për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, rezultoi se subjekti ka disponuar me vendim pushimi datë 12.10.2018. Më tej, kallëzuesi ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila me vendimin nr. ***, datë 13.2.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit V.H dhe lënien në fuqi të vendimit të pushimit të Prokurorisë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar sërish ankim nga kallëzuesi V.H dhe me vendimin nr. ***, datë 9.4.2019, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe vazhdimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, duke kthyer aktet.

28.7.1 Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm konstatohet se subjekti: (a) është vënë në lëvizje për marrjen e akteve në intervale të gjata kohore, duke mos proceduar në kohë; (b) ka marrë vendim gati pas 3 muajve nga nisja e rihetimit datë 4.3.2021, me datë 31.5.2021 (njoftuar denoncuesit më 10.6.2021), për bërjen e aktit të ekspertimit, duke mos ndërmarrë në kohë veprimin e lënë nga Gjykata.

28.7.2 Komisioni vlerëson se subjekti shfaq mangësi në drejtim të administrimit të akteve dhe mbikëqyrjen e tyre, duke ceduar kështu në efektivitetin e zbatimit të procedurave brenda afateve kohore.

28.8 Lidhur më çështjen penale nr. *** akti, datë 7.2.2022, mbi denoncimin e shtetasit K.B, me cilësinë e viktimës në këtë çështje, në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, konstatohet mosprania e subjektit të rivlerësimit si prokuror i çështjes (edhe pse në procesverbalet e seancave konfirmohet se është thirrur) në disa seanca në gjykimin e kërkesës së saj ndaj shtetasit G.D, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, për të cilin është regjistruar procedimi nr. ***, datë 4.12.2020, pa paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm, sikurse ka provuar për mungesën e saj në seancën gjyqësore të datës 28.3.2023, me depozitimin e kartelës së pacientit.

28.8.1 Komisioni vlerëson se subjekti shfaq mangësi në drejtim të efektivitetit të zhvillimit të procesit gjyqësor, ku ajo ka rolin e saj si prokurore e çështjes dhe përfaqësuese e organit të akuzës.

28.9 Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 13.07.2017, regjistruar për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, si dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 283/2, 278 dhe 287 i Kodit Penal, ku sipas informacionit për referimin e veprës penale në Prokurori janë gjetur e sekuestruar në cilësinë e provës materiale 9166 kg e 600 gr lëndë narkotike e llojit kanabis sativa, 112 kg e 500 gr e llojit hashash, tre armë zjarri automatike kallashnikov, si dhe një arkë me fishekë. Nga aktet e administruara në fashikullin

e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se ky i fundit për një pjesë të personave të arrestuar në kuadër të operacionit policor, të kapur në flagrancë, ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në burg”, ndërsa me kërkesën datë 15.07.2017, “Për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit”, për shtetasit E.T dhe M.T, ka kërkuar masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje”, parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal. Nga aktet e dosjes rezultoi se subjekti në datën 23.4.2019 ka kërkuar pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasve M, E dhe R.T. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, me qëllim hetimin pasuror të shtetasve M dhe E.T dhe lidhjet me krimin në sigurimin e kësaj pasurie, ka vlerësuar të kryejë hetime për anëtarët e tjerë të familjes T në bankat e nivelit të dytë, Qendrën Kombëtare të Biznesit, autoritetet tatimore e doganore, ZVRPP-në, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit dhe Transportit Rrugor, ndërsa sipas akteve të administruara në fashikullin penal, nuk pasqyrohen të dhëna hetimore për anëtarin e familjes R.T, i dyshuar si organizator i kësaj veprimtarie të kundërligjshme, për të cilin gjithashtu është kërkuar pushimi i procedimit. Duket se⁴ subjekti në vlerësimin e kërkesës për pushimin e çështjes edhe për shtetasin R.T, është mjaftuar vetëm me hetimin e lidhur me transkriptimet e përgjimeve telefonike dhe gjurmët papilare të këtij shtetasi.

28.9.1 Në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme dhe të plota hetimore në drejtim të qartësisë të çdo rrethane dyshuese të dalë nga hetimi për shtetasin R.T.

28.9.2 Komisioni vlerëson se subjekti shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 dhe në pikën 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

29. Në përfundim të analizimit të dokumenteve ligjore të paraqitura më lart, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit:

- ✓ Ka mangësi në aftësinë për të hetuar, duke mos ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, duke mos mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke mos interpretuar ligjin, në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kjo mangësi në rastet e analizuara në vlerësimin e trupit gjykues është e lidhur kryesisht me: (i) moskryerjen e hetimeve nga subjekti në drejtim të verifikimit të çdo dyshimi të lindur gjatë procesit hetimor, pavarësisht rezultatit përfundimtar; (ii) vlerësimin nga subjekti të rrethanave në drejtim të kualifikimit të një vepre tjetër penale, kur nga faktet rezultojnë të dhëna të tilla. Në këtë drejtim, trupi gjykues, pavarësisht bindjes së subjektit, ndalimit të Komisionit për të çmuar korrektësinë e themelit, vlerëson se mangësitë janë të tilla që mund të plotësohen duke ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.
- ✓ Ka mangësi në aspektin e administrimit të akteve dhe mbikëqyrjen e plotësisë së tyre dhe respektimit të afateve.

⁴ sipas kopjes së akteve të administruara në fashikullin e çështjes, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

- ✓ Shfaq mangësi në drejtim të prezencës së saj në ndjekjen e procedurave gjyqësore brenda kriterëve dhe afateve të nevojshme për kryerjen e një procesi të rregullt gjyqësor.

30. Për këto arsye dhe për sa janë analizuar më sipër sipas përcaktimeve të nenit 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit konsiderohet “Me mangësi”, të cilat mund të plotësohen duke ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës brenda 1 viti.

KONKLUZION

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, mbështetur në burimet e vlerësimit, rezultatet e hetimit, propësimet e subjektit të rivlerësimit me shkrim dhe në seancat dëgjimore publike, mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bisedoi në prani të vëzhguesit ndërkombëtar marrjen e vendimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aftësitë e tij profesionale, mangësi të cilat mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “b” e nenit 44, si dhe të nenit 60, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Pezullimin nga detyra të znj. Flora Çela për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
2. Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar mbi të tria kriteret e vlerësimit.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe Shkollës së Magjistraturës brenda 30 ditëve pas kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Etleđa ÇIFTJA
Anëtare